



**QËNDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

**M A T U R A   S H T E T Ë R O R E   2 0 1 8**

**RAPORT PUBLIK**

**MBI**

**ARRITJET E NXËNËSVE**

**TIRANË, Dhjetor 2018**

# Përmbajtja

|                                                                                                          |     |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| <i>Hyrje</i>                                                                                             | 3   |
| <i>Metodologjia</i>                                                                                      | 3   |
| <b>I Gjetjet kryesore</b>                                                                                | 6   |
| <b>II Lënda: Letërsi dhe Gjuhë Shqipe</b>                                                                | 12  |
| 1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>                                                                             | 12  |
| 2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë</i>                | 22  |
| 3 <i>Arritjet e nxënësve në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi - statistika krahasuese</i>                         | 25  |
| <b>III Lënda: Matematikë</b>                                                                             | 30  |
| 1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>                                                                             | 30  |
| 2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës</i>                                | 40  |
| 3 <i>Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese</i>                                       | 43  |
| <b>IV Lënda: Gjuhë e Huaj</b>                                                                            | 48  |
| 1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>                                                                             | 48  |
| 2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj</i>                             | 60  |
| 3 <i>Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese</i>                                    | 63  |
| <b>V Lëndët me Zgjedhje</b>                                                                              | 68  |
| 1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>                                                                             | 68  |
| 2 <i>Statistika përmbledhëse për MSH 2018</i>                                                            | 121 |
| <b>VI Anekse</b>                                                                                         | 122 |
| 1 <i>Të dhëna statistikore për lëndët e provimeve me zgjedhje, për nxënësit e shkollave profesionale</i> | 122 |
| 2 <i>Të dhëna statistikore për lëndët e provimeve me zgjedhje, për të gjitha llojet e shkollave</i>      | 133 |

## Hyrje

Gjatë hartimit të strategjive, çdo qeveri e sheh Arsimin si një mjet për të niveluar pabarazitë. Për të lehtësuar përfshirjen sociale dhe për të përmirësuar rezultatet socio-ekonomike, në ditët e sotme dhe për brezat e ardhshëm, qeveritë duhet t'u ofrojnë të gjithë të rinjve një shans të drejtë për të siguruar një arsim cilësor<sup>1</sup>.

Në të vërtetë, arsimi është gur themeli i përparimit të individëve përmes jetës. Përveç bazave të forta morale dhe etike që mbështesin kërkesën për barazi, për të, ka edhe evidenca që tregojnë për përfitimet ekonomike dhe shoqërore që vijnë nga një shoqëri gjithëpërfshirëse. Pabarazitë që fillojnë herët kanë tendencë të grumbullohen gjatë gjithë jetës, së pari në arsim dhe pastaj në tregun e punës, e më pas pasqyrohet në kategoritë si: statusi socio-ekonomik, statusi migrator, si dhe vendndodhja gjeografike. Prandaj, të luftosh pabarazinë në arsim është një çështje thelbësore.

Arritja e barazisë në arsim kërkon një sërë ndërhyrjesh përmes mekanizmave të ndryshëm të politikës: duke synuar financimin dhe burimet për arsimim tek më të rrezikuarit; parandalimin e përsëritjes së klasave; duke siguruar që mësimdhënësit të jenë të pajisur me trajnime të duhura dhe njohuri pedagogjike për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit në rrugën e tyre të dijes; rritjen e aksesit dhe sigurimin e arsimimit të të hershëm të fëmijëve, i cili të jetë i përballueshëm dhe të ofrohet me cilësi të lartë.

Ky raport publik shërben si material burimor për grupe të ndryshme interesi, ku ndër të parët rendisim institucionet politikbërëse të fushës së arsimit në nivel kombëtar dhe rajonal, më pas institucionet kërkimore, të cilat kërkojnë të dhëna për analiza, dhe së fundmi komunitetit të gjerë të prindërve të nxënësve, të cilët duan të monitorojnë se si shkollat ku studiojnë fëmijët e tyre po përparojnë në arritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Edhe pse Raporti Publik - Matura Shtetërore 2018 - jep informacion që mundëson krahasimin e arritjeve të nxënësve mes DAR/ZA, theksojmë se, qëllimi kryesor i këtij raporti është njohja e nivelit të arritjeve të nxënësve maturantë të sistemit arsimor kombëtar në tërësi, bazuar në rezultatet e një vlerësimi të jashtëm të standardizuar, siç është Matura Shtetërore 2018, si edhe krahasimi i tyre me arritjet vjetore të nxënësve gjatë vitit shkollor 2017-2018.

---

<sup>1</sup> Education at Glance 2018

## Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2018. Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj, si dhe lëndët me zgjedhje.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave të QSHA janë:

- numri identifikues i nxënësit (ID),
- gjinia e nxënësit,
- DAR dhe ZA (së cilës i përket shkolla që ka frekuentuar nxënësi),
- lloji i shkollës (publike/private),
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet),
- profili i studimeve që ka ndjekur nxënësi (gjimnaz, gjimnaz gjuhësor, arsim profesional, social-artistik),
- sistemi i studimeve që ka ndjekur nxënësi (me kohë të plotë/me kohë të pjesshme),
- viti shkollor kur nxënësi ka mbaruar studimet e shkollës së mesme,
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor,
- testet në provimet e maturës (që janë dhënë nga çdo nxënës),
- pikët e fituara në teste nga nxënësit,
- notat në provimet e maturës,
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët/testet e provimeve të maturës).

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve për testet e dhëna nga nxënësit në provimet e Maturës Shtetërore 2018 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar,
- në nivel DAR/ZA,
- sipas urbanizimit – fshat/qytet,
- sipas gjinisë - femra/meshkuj,
- sipas profilit të shkollës që ka ndjekur nxënësi.

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve maturantë të vitit shkollor 2017-2018, të cilët morën pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2018, sesioni i qershorit. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore 2018, të klasifikuara sipas kategorive: publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

| Nr. | Lënda e Provimit të detyruar | Numri i nxënësve që morën pjesë në provim |              |             |
|-----|------------------------------|-------------------------------------------|--------------|-------------|
|     |                              | Total                                     | Publik       | Privat      |
| 1   | <b>Letërsi</b>               | <b>34727</b>                              | <b>30262</b> | <b>4465</b> |
|     | Qytet                        | 26248                                     | 21901        | 4347        |
|     | Fshat                        | 8479                                      | 8361         | 118         |
| 2   | <b>Matematikë</b>            | <b>34713</b>                              | <b>30239</b> | <b>4474</b> |
|     | Qytet                        | 26248                                     | 21892        | 4356        |
|     | Fshat                        | 8465                                      | 8347         | 118         |
| 3   | <b>Gjuhë e Huaj</b>          | <b>34728</b>                              | <b>30256</b> | <b>4472</b> |
|     | Qytet                        | 26249                                     | 21895        | 4354        |
|     | Fshat                        | 8479                                      | 8361         | 118         |

| Nr. | Lënda e Provimit të detyruar | Numri i nxënësve që morën pjesë në provim |              |             |
|-----|------------------------------|-------------------------------------------|--------------|-------------|
|     |                              | Total                                     | Publik       | Privat      |
| 1   | <b>Letërsi</b>               | <b>34727</b>                              | <b>30262</b> | <b>4465</b> |
|     | Femra                        | 18481                                     | 16172        | 2309        |
|     | Meshkuj                      | 16246                                     | 14090        | 2156        |
| 2   | <b>Matematikë</b>            | <b>34713</b>                              | <b>30239</b> | <b>4474</b> |
|     | Femra                        | 18473                                     | 16158        | 2315        |
|     | Meshkuj                      | 16240                                     | 14081        | 2159        |
| 3   | <b>Gjuhë e Huaj</b>          | <b>34728</b>                              | <b>30256</b> | <b>4472</b> |
|     | Femra                        | 18484                                     | 16171        | 2313        |
|     | Meshkuj                      | 16244                                     | 14085        | 2159        |

Përpunimi i të dhënave u realizua nëpërmjet software -ve Statistika dhe SPSS.

Informacioni statistikor i përftuar nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim,
- Nota mesatare Vjetore - (NV),
- Nota mesatare e Maturës - (NM),
- Shmangia standarde – (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*),
- Nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk),
- Nota mesatare e Maturës në nivel kombëtar - (NMk),
- Kalueshmëria në provimin e Maturës,
- Diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën e Maturës në nivel kombëtar - (NM – NMk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën Vjetore - (NM – NV).

## I. Gjetjet kryesore

Gjetjet kryesore të raportit bazohen në analizën e arritjeve të nxënësve maturantë, të cilët morën pjesë në provimet e lëndëve të detyruara dhe të lëndëve me zgjedhje të Sesionit të Parë, të Maturës Shtetërore 2018.

### A) Lënda: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

|                                                                       |        |
|-----------------------------------------------------------------------|--------|
| • Numri i nxënësve që morën pjesë në provim                           | 34727  |
| • Kalueshmëria në provimin e maturës                                  | 96.78% |
| • Mesatarja e pikëve të fituara në provim                             | 24.24  |
| • Nota mesatare në provimin e maturës                                 | 6.67   |
| • Nota mesatare vjetore                                               | 7.13   |
| • Përqindja e nxënësve të vlerësuar më notën 10 në provimin e maturës | 0.64%  |

*Referuar arritjeve mesatare në provimin e maturës, nxënësit që ndjekin shkollat e Gjuhëve të Huaja dhe Seksioni 2-gjuhësh kanë arritje më të larta kundrejt nxënësve të profileve të tjera, kjo si në provimin e Maturës 2018, po ashtu edhe në rezultatet Vjetore 2018.*

**86% e nxënësve që janë vlerësuar 47-50 pikë në provimin e maturës janë nxënës të gjimnazeve publike, ku mbizotërojnë gjimnazet e qytetit të Tiranës.**

**3% e nxënësve që janë vlerësuar 47-50 pikë në provimin e maturës janë nxënës të gjimnazeve publike të fshatit.**

*Arritjet mesatare të nxënësve të sistemit publik janë më të qëndrueshme krahasuar me arritjet mesatare të nxënësve të sistemit privat.*

Për sistemin privat, arritjet mesatare në provimin e maturës janë 1.07 njësi notë më të ulta kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, ndërsa për nxënësit e sistemit publik, arritjet mesatare në provimin e maturës janë 0.40 njësi note më të ulta kundrejt arritjeve mesatare vjetore.

*Arritjet mesatare të nxënësve, në provimin e maturës, për sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.*

*Arritjet mesatare në Maturën 2018, si dhe ato Vjetore 2018 të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt nxënësve të fshatit.*

*Arritjet mesatare të vajzave, në provimin e maturës, janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve. Mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth 7 pikë më e lartë krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë. Por duhet theksuar se vajzat kanë një vlerësim shumë më të ulët në rezultate në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore.*

*Arritjet mesatare të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të nxënësve të fshatit.*

*Për kategorinë qytet, numri i nxënësve të vlerësuar me notën 4 në provimin e maturës është rreth 0,6 herë më i lartë kundrejt numrit të nxënësve të fshatit të vlerësuar me të njëjtën notë 4.*

*Përqindja e mbetësve në provimin e maturës për kategorinë “meshkuj” është më e lartë krahasuar me kategorinë “femra”.*

*Për notat 7, 8, 9 e 10 të rezultateve të provimit të maturës, vihet re përqindja dominuese e kategorisë “femra” kundrejt kategorisë së “meshkujve”.*

- 11 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar (Delvinë, Dibër, Durrës, Kavajë, Korçë, Lezhë, Përmet, Pogradec, Sarandë, Tiranë Bashki dhe Vlorë),
- 9 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **ndjeshëm nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar (Shkodër, Malësi e Madhe, Tepelenë, Bulqizë, Skrapar, Elbasan, Mirditë, Mat, Kuçovë).
- 2 DAR/ZA kanë arritje në provimin e maturës më të larta se arritjet vjetore. Këtu përmendim ZA Kamëz dhe Përmet.

*Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, 6 e 7, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 8, 9 e 10.*

*Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 9 e 10, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 5 e 6.*

## B) Lënda: Matematikë

|                                                                       |        |
|-----------------------------------------------------------------------|--------|
| • Numri i nxënësve që morën pjesë në provim                           | 34713  |
| • Kalueshmëria në provimin e maturës                                  | 94.53% |
| • Mesatarja e pikëve të fituara në provim                             | 22.45  |
| • Nota mesatare në provimin e maturës                                 | 6.38   |
| • Nota mesatare vjetore                                               | 6.43   |
| • Përqindja e nxënësve të vlerësuar më notën 10 në provimin e maturës | 7.07%  |

*Arritjet mesatare të nxënësve, në nivel kombëtar, në provimin e maturës janë pak më të ulta krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.*

*Arritjet mesatare të nxënësve të sistemit publik – gjimnazet janë më të qëndrueshme krahasuar me arritjet mesatare të nxënësve të sistemit privat.*

*Referuar arritjeve mesatare në provimin e maturës, **nxënësit që ndjekin gjimnazet kanë arritje më të larta** kundrejt nxënësve të profileve të tjera, kjo si në provimin e Maturës 2018, po ashtu edhe në rezultatet Vjetore 2018.*

*Nxënësit e gjimnazeve publike kanë arritje mesatare më të larta se arritjet mesatare vjetore (edhe pse ndryshimi është shumë i vogël).*

*Nota mbizotëruese në procesin mësimor në lëndën e matematikës është 5 me 43.13% të totalit të nxënësve, që tregon se arritjet e nxënësve kanë qenë të ulta.*

**74% e nxënësve që janë vlerësuar me 49-50 pikë në provimin e maturës janë nxënës të gjimnazeve publike.**

**4% e nxënësve që janë vlerësuar me 49-50 pikë në provimin e maturës janë nxënës të gjimnazeve publike të fshatit.**

*Arritjet mesatare të nxënësve, në provimin e maturës, për sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.*

*Për sistemin publik, arritjet mesatare në Maturën 2018, si dhe ato Vjetore 2018 të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt nxënësve të fshatit.*

*Për sistemin privat, arritjet mesatare në Maturën 2018, të nxënësve të fshatit janë më të larta kundrejt nxënësve të qytetit.*

*Arritjet mesatare të vajzave janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve. Në nivel kombëtar, mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth 5.09 pikë mbi nivelin e pikëve mesatare të fituara nga djemtë. Arritjet mesatare të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të nxënësve të fshatit.*

*Përqindja e mbetësve në provimin e maturës për kategorinë “meshkuj” është afërsisht 2 herë më e madhe krahasuar me kategorinë “femra”.*

*Për notat 8, 9 e 10 të rezultateve të provimit të maturës, vihet re përqindja dominuese e kategorisë “femra” kundrejt kategorisë së “meshkujve”.*

- 19 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) mbi vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si Dibër, Durrës, Gramsh, Has, Kavajë, Kolonjë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Peqin, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë, Tirana Bashki, Tropojë, Vlorë;
- 13 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) ndjeshëm nën vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si Bulqizë, Delvinë, Devoll, Elbasan, Gjirokastrë, Kamëz, Kuçovë, Mat, Mirditë, Skrapar, Tepelenë, Tiranë Qark.

*Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, 6 e 7, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 8, 9 e 10.*

*Ka nxënës, të cilët gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 9 e 10, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 5 e 6.*

### **C) Lënda: Gjuhë e Huaj**

|                                                                       |        |
|-----------------------------------------------------------------------|--------|
| • Numri i nxënësve që morën pjesë në provim                           | 34728  |
| • Kalueshmëria në provimin e maturës                                  | 98.79% |
| • Mesatarja e pikëve të fituara në provim                             | 32.48  |
| • Nota mesatare në provimin e maturës                                 | 7.78   |
| • Nota mesatare vjetore                                               | 7.19   |
| • Përqindja e nxënësve të vlerësuar më notën 10 në provimin e maturës | 20.21% |

*Arritjet mesatare të nxënësve, në nivel kombëtar, në provimin e maturës janë pak më të ulta krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve.*

*Arritjet mesatare më të larta për të gjitha gjuhët e huaja i kanë arritur nxënësit e shkollave gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2 gjuhësh.*

*Përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës është 20.21% e totalit të nxënësve, prej të cilëve vetëm 1.68% i përkasin nxënësve të shkollave të fshatit.*

*Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor është 18.81%, ku nxënësit e fshatit përbëjnë 2.08%.*

*Arritjet mesatare më të larta në provimin e maturës i kanë arritur nxënësit, të cilët mësojnë gjuhë të huaj anglisht, më pas vjen gjuha gjermane, italiane dhe frënge. Mesatarja e pikëve të fituara në testim për gjuhën e huaj anglisht është 33.87 pikë, gjermanisht 28.63 pikë, italisht 26.07 pikë, dhe frëngjisht 19.50 pikë.*

*Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës i përket përsëri gjuhës së huaj angleze, përkatësisht me 22.24%, e pasuar nga gjuha gjermane me 17.65%.*

#### **D) Lëndët me Zgjedhje**

|                                                                       |        |
|-----------------------------------------------------------------------|--------|
| • Numri i nxënësve që morën pjesë në provim                           | 64713  |
| • Kalueshmëria në provimin e maturës                                  | 97.00% |
| • Mesatarja e pikëve të fituara në provim                             | 22.50  |
| • Nota mesatare në provimin e maturës                                 | 6.90   |
| • Nota mesatare vjetore                                               | 7.64   |
| • Përqindja e nxënësve të vlerësuar më notën 10 në provimin e maturës | 10.25% |

Pothuajse në gjitha lëndët me zgjedhje, si për sistemin privat po ashtu edhe për sistemin publik, për të dy kategoritë qytet apo fshat, vajza apo djem, **arritjet e nxënësve në provimin e maturës janë më të ulta kundrejt arritjeve vjetore.** Kjo diferencë është me e theksuar për sistemin privat.

Në nivel kombëtar, nxënësit e qytetit kanë arritje më të larta krahasuar me arritjet e nxënësve të fshatit. Kjo gjetje qëndron si për sistemin publik, po ashtu edhe sistemin privat.

Nxënësit e sistemit privat kanë arritje më të larta referuar nxënësve të sistemit publik.

Në nivel kombëtar vajzat kanë arritje më të larta se sa djemtë. Kjo gjetje qëndron si për sistemin publik, po ashtu edhe sistemin privat.

Ka shumë DAR/ZA, **nxënësit e të cilëve nuk kanë marrë pjesë në testet e lëndëve të thelluara**, si Bulqizë, Delvinë, Gjirokastër, Has, Malësi e Madhe, Mallakastër, Mirditë, Peqin, Përmet

**Qytetari:** Ulja e arritjeve të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, në sistemin privat, është e lartë për kategorinë e vajzave, ku diferenca NM-NV= -2.31 njësi note.

**Ekonomi e thelluar** - Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit publik të arsimit, kategoria fshat, ku vlera e kësaj difference shkon në 3.38 (nota vjetore 9.56, ndërsa nota e maturës 6.18).

**Kimi bërthamë:** Diferenca mes notës vjetore dhe notës së maturës është në kufijtë e rreth 2.34 njësi note (9.34 – nota vjetore; 7.00 nota e maturës). Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit privat të arsimit, kategoria qytet ku vlera e kësaj difference shkon në 2.62 (nota vjetore 9.58, ndërsa nota e maturës 6.94).

**Kimi e thelluar:** Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit publik të arsimit, kategoria fshat ku vlera e kësaj difference shkon në 2.81 njësi note (nota vjetore 9.70, ndërsa nota e maturës 6.89).

**Fizikë bërthamë:** Diferenca më e madhe mes notes vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit publik të arsimit, kategoria fshat, ku vlera e kësaj difference shkon në 2.50 (nota vjetore 8.89, ndërsa nota e maturës 6.39).

**Biologji e thelluar:** Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit privat të arsimit, kategoria fshat, ku vlera e kësaj difference shkon në 3.00 (nota vjetore 9.70, ndërsa nota e maturës 6.70).

**Gjeografi bërthamë:** Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit privat të arsimit, kategoria qytet, ku vlera e kësaj difference shkon në 2.02 njësi note (nota vjetore 7.71, ndërsa nota e maturës 5.69).


**Histori bërthamë:** Diferenca më e madhe mes notës vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit privat të arsimit, kategoria qytet, ku vlera e kësaj difference shkon në 2.02 (nota vjetore 8.37, ndërsa nota e maturës 6.35).

**Matematike e thelluar:** Diferenca më e madhe mes notes vjetore dhe notës së maturës i përket sistemit privat të arsimit, kategoria qytet, ku vlera e kësaj difference shkon në 1.93 (nota vjetore 9.25, ndërsa nota e maturës 7.32).

## II. Lënda: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi

### 1) Arritjet e Nxënësve

Grafikët e mëposhtëm japin një informacion krahasues, në nivel DAR/ZA, të arritjeve të nxënësve në provimin e maturës, si dhe të arritjeve vjetore për lëndën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe. Grafikët tregojnë përqindjet e nxënësve, njohuritë e të cilëve ndodhen në intervalin “nën nivelin mesatar” dhe



“mbi nivelin mesatar”. Si nivel mesatar është konsideruar kufiri mes notës shtatë dhe tetë. Për arritjet e Maturës 2018, në nivel kombëtar, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-nën nivelin mesatar” është 63,8% kundrejt 55.9% në arritjet vjetore. Ndërkohë, përqindja e nxënësve që ndodhen në intervalin “mesatar-mbi nivelin mesatar” është 36.2% për arritjet në provimin e maturës kundrejt 44.1% për arritjet vjetore. Grafiku tregon se, DAR/ZA Berat, Has, Tepelenë, Skrapar, Mirditë, Librazhd dhe Peqin dhe Has kanë diferenca të theksuara mes arritjeve vjetore dhe arritjeve në provimin e maturës.

**Tabela L - 1** paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë. Arritjet e nxënësve janë dhënë në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet**, sipas **gjinisë femra/meshkuj**, si edhe sipas **sistemit publik/privat të edukimit**.

### **I. Në nivel kombëtar:**

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e maturës në lëndën e Gjuhës Shqipe dhe të Letërsisë është **24.24 pikë**, me shmangie mesatare 9.02,
- **nota mesatare e maturës është 6.67**, me shmangie mesatare 1.28,
- **nota mesatare vjetore është 7.13**, me shmangie mesatare 1.73.

**Pra, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të maturës, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se ndryshueshmëria mes dy vlerave është 0.46 njësi notë.**

### **II. Arritjet sipas gjinisë:**

- arritjet mesatare, në provimin e maturës, për vajzat janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve,
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth 7 pikë më e lartë krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë,
- nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve në provimin e maturës me arritjet vjetore të tyre, rezulton se, vajzat kanë marrë një vlerësim shumë më të ulët në rezultate në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore të tyre (nota mesatare në maturë është 7.14 kundrejt 7.81 që është nota mesatare vjetore) në krahasim me djemtë, të cilët kanë nota mesatare në maturë është 6.13 kundrejt 6.32 që është nota mesatare vjetore.

### **III. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat:**

Nëse do të analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat,
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth 4.11 pikë më e lartë ndaj nxënësve të fshatit,
- ekzistenca e diferencës prej 4.11 pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën e notës mesatare që ekziston mes dy kategorive, vlera e të cilës është me 0.58 njësi notë.

Në nivel kombëtar, diferencat ekzistojnë mes vajzave që kanë ndjekur shkollën në qytet me vajzat që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Për të tre treguesit statistikorë të Tabelës L-1, shihet se arritjet e vajzave në qytet janë më të larta kundrejt vajzave të fshatit. Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, vajzat e qytetit kanë një notë mesatare me një vlerë prej 0.49 më të lartë se vajzat e fshatit. Kjo diferencë, është më e madhe nëse i referohemi arritjeve në provimin e maturës. Vlera e kësaj difference shkon në 0.58 notë, e cila rrjedh nga diferenca prej 4.30 pikësh për mesataren e pikëve në testim. Nga të dhënat e Tabelës L-1 rezulton se, të njëjtën situatë kemi kur krahasojmë arritjet mesatare për djemtë e qytetit kundrejt djemve të fshatit.

#### IV. Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit:

Diferenca të mëdha ekzistojnë edhe mes dy sistemeve arsimore (publik/privat) që ekzistojnë në vendin tonë. Nga të dhënat e Tabelës L-1 rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik,
- kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të maturës dhe atë vjetore.
- të njëjtat dallime ekzistojnë edhe nëse krahasojmë arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin privat me arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin publik, si edhe për kategoritë fshat/qytet në privat kundrejt kategorive fshat/qytet në sistemin publik.

Tabela L-1

| Urbanizimi          | Gjinia       | Pikët e fituara në test |                   | Nota e Maturës |                   | Nota Vjetore  |                   |
|---------------------|--------------|-------------------------|-------------------|----------------|-------------------|---------------|-------------------|
|                     |              | Mesatarja e pikëve      | Shmangia mesatare | Nota mesatare  | Shmangia mesatare | Nota mesatare | Shmangia mesatare |
| <b>Total</b>        | Femra        | 27.55                   | 8.34              | 7.14           | 1.15              | 7.81          | 1.51              |
|                     | Meshkuj      | 20.47                   | 8.25              | 6.13           | 1.21              | 6.32          | 1.61              |
|                     | <b>Total</b> | <b>24.24</b>            | <b>9.02</b>       | <b>6.67</b>    | <b>1.28</b>       | <b>7.13</b>   | <b>1.73</b>       |
| <b>Qytet</b>        | Femra        | 28.64                   | 8.25              | 7.29           | 1.13              | 7.93          | 1.50              |
|                     | Meshkuj      | 21.47                   | 8.38              | 6.28           | 1.22              | 6.49          | 1.64              |
|                     | <b>Total</b> | <b>25.24</b>            | <b>9.05</b>       | <b>6.81</b>    | <b>1.28</b>       | <b>7.26</b>   | <b>1.73</b>       |
| <b>Fshat</b>        | Femra        | 24.34                   | 7.75              | 6.71           | 1.10              | 7.44          | 1.48              |
|                     | Meshkuj      | 17.19                   | 6.83              | 5.65           | 1.04              | 5.73          | 1.36              |
|                     | <b>Total</b> | <b>21.13</b>            | <b>8.17</b>       | <b>6.23</b>    | <b>1.20</b>       | <b>6.71</b>   | <b>1.66</b>       |
| <b>Publik total</b> | Femra        | 27.05                   | 8.36              | 7.07           | 1.16              | 7.66          | 1.51              |
|                     | Meshkuj      | 19.78                   | 8.08              | 6.03           | 1.19              | 6.09          | 1.53              |
|                     | <b>Total</b> | <b>23.66</b>            | <b>8.99</b>       | <b>6.59</b>    | <b>1.28</b>       | <b>6.95</b>   | <b>1.71</b>       |
| <b>Qytet</b>        | Femra        | 28.16                   | 8.33              | 7.23           | 1.14              | 7.76          | 1.51              |
|                     | Meshkuj      | 20.77                   | 8.30              | 6.17           | 1.22              | 6.22          | 1.56              |
|                     | <b>Total</b> | <b>24.68</b>            | <b>9.10</b>       | <b>6.73</b>    | <b>1.29</b>       | <b>7.05</b>   | <b>1.71</b>       |
|                     | Femra        | 24.25                   | 7.74              | 6.69           | 1.10              | 7.42          | 1.48              |

|                     |              |              |             |             |             |             |             |
|---------------------|--------------|--------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
| <b>Fshat</b>        | Meshkuj      | 17.06        | 6.73        | 5.63        | 1.03        | 5.71        | 1.34        |
|                     | <b>Total</b> | <b>21.02</b> | <b>8.13</b> | <b>6.21</b> | <b>1.19</b> | <b>6.69</b> | <b>1.66</b> |
| <b>Privat total</b> | Femra        | 31.08        | 7.32        | 7.63        | 0.97        | 8.81        | 1.14        |
|                     | Meshkuj      | 24.92        | 7.90        | 6.78        | 1.11        | 7.72        | 1.39        |
|                     | <b>Total</b> | <b>28.11</b> | <b>8.20</b> | <b>7.22</b> | <b>1.13</b> | <b>8.29</b> | <b>1.38</b> |
| <b>Qytet</b>        | Femra        | 31.09        | 7.37        | 7.63        | 0.98        | 8.82        | 1.14        |
|                     | Meshkuj      | 24.87        | 7.91        | 6.78        | 1.12        | 7.73        | 1.39        |
|                     | <b>Total</b> | <b>28.08</b> | <b>8.25</b> | <b>7.22</b> | <b>1.13</b> | <b>8.30</b> | <b>1.38</b> |
| <b>Fshat</b>        | Femra        | 30.67        | 5.64        | 7.58        | 0.74        | 8.49        | 1.11        |
|                     | Meshkuj      | 27.18        | 6.91        | 7.11        | 0.92        | 7.39        | 1.38        |
|                     | <b>Total</b> | <b>29.22</b> | <b>6.41</b> | <b>7.39</b> | <b>0.85</b> | <b>8.03</b> | <b>1.34</b> |

## V. Qëndrueshmëria e arritjeve:

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, shihet se nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo situatë është e vlefshme për kategoritë: femra/meshkuj, si dhe qytet/fshat.

Nga të dhënat e Tabelës L-1 rezulton se:

- në sistemin privat, arritjet mesatare në provimin e maturës janë 1.07 njësi notë më të ulta kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, kur ndërkohë për nxënësit e sistemit publik arritjet mesatare ndryshojnë me një vlerë prej 0.40 njësi notë. Pra rezulton se, qëndrueshmëria e arritjeve mesatare të nxënësve është më e lartë në sistemin publik kundrejt sistemit privat.
- Për sistemin publik, shihet se arritjet e djemve në qytet janë më të larta kundrejt arritjeve të djemve të fshatit. E njëjta situatë qëndron edhe për sistemin privat.

**Tabela L-2** paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas **profilit të shkollës së ndjekur**, si dhe sipas **llojit të shkollës publike apo private**.

Tabela L-2

| <b>Profili i shkollës</b>                      | <b>Pikët e fituara në test</b> |                   | <b>Nota e Maturës</b> |                   | <b>Nota Vjetore</b> |                   |
|------------------------------------------------|--------------------------------|-------------------|-----------------------|-------------------|---------------------|-------------------|
|                                                | Mesatarja e pikëve             | Shmangia mesatare | Nota mesatare         | Shmangia mesatare | Nota mesatare       | Shmangia mesatare |
| Gjimnaz                                        | 25.40                          | 8.80              | 6.84                  | 1.24              | 7.30                | 1.72              |
| Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh        | 26.78                          | 8.62              | 7.04                  | 1.19              | 7.32                | 1.63              |
| <b>TOTAL</b> Artistike; Koreografike, Sportive | 20.69                          | 7.14              | 6.19                  | 1.05              | 6.45                | 1.35              |
| Teknike profesionale                           | 17.33                          | 6.75              | 5.66                  | 1.04              | 6.08                | 1.35              |
| Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar                  | 14.49                          | 5.59              | 5.23                  | 0.89              | 5.66                | 1.04              |


|               |                                         |       |      |      |      |      |      |
|---------------|-----------------------------------------|-------|------|------|------|------|------|
| <b>PUBLIK</b> | Gjimnaz                                 | 24.89 | 8.81 | 6.77 | 1.24 | 7.12 | 1.72 |
|               | Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh | 26.78 | 8.62 | 7.04 | 1.19 | 7.32 | 1.63 |
|               | Artistike; Koreografike, Sportive       | 20.69 | 7.14 | 6.19 | 1.05 | 6.45 | 1.35 |
|               | Teknike profesionale                    | 16.81 | 6.32 | 5.59 | 0.98 | 5.94 | 1.25 |
|               | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar           | 14.49 | 5.59 | 5.23 | 0.89 | 5.66 | 1.04 |
| <b>PRIVAT</b> | Gjimnaz                                 | 28.40 | 8.10 | 7.26 | 1.11 | 8.33 | 1.37 |
|               | Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh | -     | -    | -    | -    | -    | -    |
|               | Artistike; Koreografike, Sportive       | -     | -    | -    | -    | -    | -    |
|               | Teknike profesionale                    | 23.63 | 8.42 | 6.59 | 1.21 | 7.65 | 1.36 |
|               | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar           | -     | -    | -    | -    | -    | -    |

Bazuar në të dhënat e Tabelës L-2, për totalin e nxënësve dhe kategorinë publik rezulton se:

- nxënësit që ndjekin shkollat e Gjuhëve të Huaja dhe Seksioni 2-gjuhësh kanë rezultate më të larta kundrejt nxënësve të profileve të tjera, kjo si në provimin e Maturës 2018, po ashtu edhe në rezultatet Vjetore 2018.
- Për sistemin privat nxënësit më të mirë rezultojnë të jenë nxënësit e shkollave të gjimnazit.

Tabela L-3

| Nr.                             | Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve | Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës (në %) |               |               |               |               |              |              |
|---------------------------------|----------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|--------------|
|                                 |                                              | 4                                                  | 5             | 6             | 7             | 8             | 9            | 10           |
| 1                               | Gjimnaz                                      | 1.98%                                              | 10.60%        | 16.60%        | 25.24%        | 21.15%        | 7.01%        | 0.60%        |
| 2                               | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh      | 0.03%                                              | 0.20%         | 0.43%         | 0.72%         | 0.62%         | 0.25%        | 0.03%        |
| 3                               | Artistike; Koreografike, Sportive            | 0.05%                                              | 0.31%         | 0.48%         | 0.45%         | 0.14%         | 0.03%        | 0.00%        |
| 4                               | Teknike profesionale                         | 0.80%                                              | 4.10%         | 3.21%         | 1.82%         | 0.59%         | 0.07%        | 0.01%        |
| <b>Në nivel kombëtar (dita)</b> |                                              | <b>2.85%</b>                                       | <b>15.21%</b> | <b>20.73%</b> | <b>28.23%</b> | <b>22.49%</b> | <b>7.37%</b> | <b>0.64%</b> |
| 5                               | Gjimnaz -me kohë të shkurtuar                | 0.36%                                              | 1.25%         | 0.58%         | 0.24%         | 0.04%         | 0.00%        | 0.00%        |
| <b>Në nivel kombëtar</b>        |                                              | <b>3.22%</b>                                       | <b>16.46%</b> | <b>21.31%</b> | <b>28.48%</b> | <b>22.53%</b> | <b>7.37%</b> | <b>0.64%</b> |



Grafiku L-3

Tabela L-3, Tabela L-4, Grafiku L-3 e Grafiku L-4, japin shpërndarjen e notave (në përqindje) të provimit të maturës dhe notave vjetore për lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.


**Në nivel kombëtar, në provimin e maturës:**

- kalueshmëria është **96.78%**,
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 7 me 28.48%**,
- notat 6, 7 dhe 8 kanë vlera në përqindje, shuma e të cilave përbën rreth 72% të totalit të nxënësve,
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës është mjaft e ulët (0.64%).

Tabela L-4

| Nr.                             | Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve | Shpërndarja e Notave Vjetore (në %) |               |               |               |               |               |
|---------------------------------|----------------------------------------------|-------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
|                                 |                                              | 5                                   | 6             | 7             | 8             | 9             | 10            |
| 1                               | Gjimnaz                                      | 17.49%                              | 12.60%        | 13.25%        | 13.72%        | 14.32%        | 12.52%        |
| 2                               | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh      | 0.39%                               | 0.41%         | 0.38%         | 0.46%         | 0.39%         | 0.28%         |
| 3                               | Artistike; Koreografike, Sportive            | 0.46%                               | 0.34%         | 0.28%         | 0.21%         | 0.10%         | 0.04%         |
| 4                               | Teknike profesionale                         | 4.54%                               | 2.31%         | 1.38%         | 1.05%         | 0.56%         | 0.24%         |
| <b>Në nivel kombëtar (dita)</b> |                                              | <b>22.88%</b>                       | <b>15.66%</b> | <b>15.29%</b> | <b>15.45%</b> | <b>15.38%</b> | <b>13.08%</b> |

|                          |                               |               |               |               |               |               |               |
|--------------------------|-------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| 5                        | Gjimnaz –me kohë të shkurtuar | 1.24%         | 0.58%         | 0.26%         | 0.10%         | 0.05%         | 0.01%         |
| <b>Në nivel kombëtar</b> |                               | <b>24.12%</b> | <b>16.25%</b> | <b>15.55%</b> | <b>15.55%</b> | <b>15.44%</b> | <b>13.09%</b> |



Grafiku L-4

Arritjet vjetore të paraqitura në Tabelën L-4 tregojnë për një shpërndarje pothuajse uniforme mes notave 6, 7, 8 e 9, ku vlerat e përqindjeve të nxënësve të vlerësuar me ato nota janë pothuajse në vlera të përafërta. Shuma e tyre arrin në afërsisht 62% të totalit të nxënësve. Përqindja e lartë e nxënësve të vlerësuar me notën 10, e cila ka arritur vlerën prej 13.08% të nxënësve, tregon se diferenca mes numrit të nxënësve të vlerësuar me notën 9 kundrejt atyre me notën 10 është afërsisht 2.33% më shumë. Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 5 gjatë vitit shkollor arrin vlerën prej rreth 24.12% të totalit të nxënësve.

Të dhëna mbi përqindjet e notave në nivel kombëtar sipas urbanizimit qytet/fshat, dhe gjinisë femra/meshkuj për provimin e Maturës 2018 dhe arritjet Vjetore 2018 janë dhënë në formë tabelare dhe grafike, përkatësisht në Tabelën L-5 dhe Tabelën L-6.

Tabela L-5 tregon se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës është 0.64% e totalit të nxënësve, prej të cilëve 0.02% janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat, dhe 0.62% i përkasin kategorisë qytet.

Rezultatet e arritura në Maturën 2018, si dhe ato Vjetore 2018 të nxënësve të qytetit janë më të larta kundrejt nxënësve të fshatit. Duhet theksuar se, edhe në popullatën e individëve të kategorisë fshat, kemi praninë e nxënësve, të cilët janë vlerësuar me nota të larta 9 e 10.

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën L-6 dhe Grafiku L-6 vihet re se, vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e maturës. Por, nëse do të analizojmë popullatën e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë vitit shkollor, dhe treguesin e qëndrueshmërisë së rezultateve, vihet re se qëndrueshmëria e arritjeve të nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë vitit

shkollor është më e lartë tek vajzat. Numri i vajzave, të vlerësuara me notën 10 gjatë vitit shkollor dhe që e kanë mbajtur të njëjtin rezultat (pra notën 10) edhe në provimin e maturës, është më i madh krahasuar me numrin e djemve që e kanë ruajtur përsëri vlerësimin me notën 10 edhe në provimin e maturës.

Nga të dhënat e Tabelës L-5 dhe Tabelës L-6, si dhe grafikëve përkatës, për Lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, rezulton se:

- Për kategorinë qytet, numri i nxënësve të vlerësuar me notën 4 në provimin e maturës është rreth 0,6 herë më i lartë kundrejt numrit të nxënësve të fshatit të vlerësuar me të njëjtën notë 4.
- Përqindja e mbetësve në provimin e maturës për kategorinë “meshkuj” është më e lartë krahasuar me kategorinë “femra”.
- Për notat 7, 8, 9 e 10 të rezultateve të provimit të maturës, vihet re përqindja dominuese e kategorisë “femra” kundrejt kategorisë së “meshkujve”.

# Përqindjet e notave në nivel kombëtar

Tabela L-5

## LETËRSI


### Matura 2018

| Nota           | Urbanizimi |        | Gjithsej |
|----------------|------------|--------|----------|
|                | Fshat      | Qytet  |          |
| <b>Nota 4</b>  | 1.27%      | 1.95%  | 3.22%    |
| <b>Nota 5</b>  | 5.61%      | 10.85% | 16.46%   |
| <b>Nota 6</b>  | 6.55%      | 14.76% | 21.31%   |
| <b>Nota 7</b>  | 6.72%      | 21.76% | 28.48%   |
| <b>Nota 8</b>  | 3.56%      | 18.97% | 22.53%   |
| <b>Nota 9</b>  | 0.69%      | 6.68%  | 7.37%    |
| <b>Nota 10</b> | 0.02%      | 0.62%  | 0.64%    |


### Vjetore 2018

| Nota           | Urbanizimi |        | Gjithsej |
|----------------|------------|--------|----------|
|                | Fshat      | Qytet  |          |
| <b>Nota 4</b>  | 0.00%      | 0.00%  | 0.00%    |
| <b>Nota 5</b>  | 7.59%      | 16.53% | 24.12%   |
| <b>Nota 6</b>  | 4.43%      | 11.82% | 16.25%   |
| <b>Nota 7</b>  | 3.75%      | 11.81% | 15.55%   |
| <b>Nota 8</b>  | 3.27%      | 12.28% | 15.55%   |
| <b>Nota 9</b>  | 2.81%      | 12.62% | 15.44%   |
| <b>Nota 10</b> | 1.92%      | 11.17% | 13.09%   |

Përqindjet e notave sipas urbanizimit  
Matura 2018



Përqindjet e notave sipas urbanizimit  
Vjetore 2018



Përqindjet e notave në nivel kombëtar

Tabela L-6

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI


Matura 2018

| Nota    | Gjinia |         | Gjithsej |
|---------|--------|---------|----------|
|         | Femra  | Meshkuj |          |
| Nota 4  | 0.64%  | 2.57%   | 3.22%    |
| Nota 5  | 3.98%  | 12.48%  | 16.46%   |
| Nota 6  | 8.49%  | 12.81%  | 21.31%   |
| Nota 7  | 17.23% | 11.25%  | 28.48%   |
| Nota 8  | 16.24% | 6.29%   | 22.53%   |
| Nota 9  | 6.09%  | 1.28%   | 7.37%    |
| Nota 10 | 0.55%  | 0.09%   | 0.64%    |


Vjetore 2018

| Nota    | Gjinia |         | Gjithsej |
|---------|--------|---------|----------|
|         | Femra  | Meshkuj |          |
| Nota 4  | 0.00%  | 0.00%   | 0.00%    |
| Nota 5  | 4.44%  | 19.68%  | 24.12%   |
| Nota 6  | 7.92%  | 8.33%   | 16.25%   |
| Nota 7  | 9.72%  | 5.84%   | 15.55%   |
| Nota 8  | 10.61% | 4.94%   | 15.55%   |
| Nota 9  | 11.52% | 3.92%   | 15.44%   |
| Nota 10 | 10.23% | 2.86%   | 13.09%   |

Përqindjet e notave sipas gjinisë  
Matura 2018



Përqindjet e notave sipas gjinisë  
Vjetore 2018



Nga të dhënat e analizuara më lart, rezulton se, arritjet e nxënësve në provimin e Maturës 2018 karakterizohen nga *“paqëndrueshmëria”* duke i krahasuar ato me arritjet Vjetore 2018. Tabela L-7 jep informacion mbi nivelin e paqëndrueshmërisë së rezultateve Vjetore 2018 (për të cilat nxënësit janë vlerësuar gjatë gjithë vitit shkollor 2017-2018), të krahasuara me rezultatet e marra në provimin e Maturës 2018, për lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë.

Tabela L-7

| Notat vjetore<br>(në %) |         | Notat e Provimit të Maturës (në %) |        |        |        |        |       |       |
|-------------------------|---------|------------------------------------|--------|--------|--------|--------|-------|-------|
|                         |         | 4                                  | 5      | 6      | 7      | 8      | 9     | 10    |
| pa notë                 | 4.47%   | 1.46%                              | 1.81%  | 0.84%  | 0.30%  | 0.07%  | 0.00% | 0.00% |
| 5                       | 23.04%  | 1.34%                              | 9.55%  | 8.30%  | 3.44%  | 0.40%  | 0.02% | 0.00% |
| 6                       | 15.52%  | 0.31%                              | 3.17%  | 5.72%  | 5.12%  | 1.12%  | 0.08% | 0.00% |
| 7                       | 14.86%  | 0.07%                              | 1.34%  | 3.63%  | 6.69%  | 2.84%  | 0.28% | 0.01% |
| 8                       | 14.86%  | 0.03%                              | 0.45%  | 1.83%  | 6.18%  | 5.37%  | 0.96% | 0.03% |
| 9                       | 14.75%  | 0.006%                             | 0.11%  | 0.78%  | 4.64%  | 6.89%  | 2.21% | 0.11% |
| 10                      | 12.51%  | 0.00%                              | 0.02%  | 0.21%  | 2.10%  | 5.85%  | 3.83% | 0.49% |
| Gjithsej                | 100.00% | 3.22%                              | 16.46% | 21.31% | 28.48% | 22.53% | 7.37% | 0.64% |

Tabela L-7 lexohet si më poshtë:

- ❖ Nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve të vlerësuar gjatë vitit shkollor, vetëm 12.51% e tyre kanë marrë notën 10, në Lëndën e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë, ndërkohë që, nxënësit, të cilët edhe në provimin e Maturës e kanë ruajtur vlerësimin me notën 10 është 0.49% e totalit të nxënësve.
- ❖ në sistemin privat, arritjet e nxënësve në provimin e maturës janë më të ulta krahasuar me arritjet e vjetore të tyre, përkatësisht me 0.35 njësi note.

#### V. Qëndrueshmëria e arritjeve:

Analiza e **qëndrueshmërisë së arritjeve** të nxënësve në provimin e maturës kundrejt arritjeve vjetore, tregon se, për lëndën e matematikës, nxënësit e sistemit publik kanë arritje më të qëndrueshme krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Gjithashtu, edhe për sistemin publik, arritjet e nxënësve të qytetit janë më të qëndrueshme krahasuar me arritjet e nxënësve të fshatit.

Tabela M-2 paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas profilit të shkollës së ndjekur, si dhe sipas llojit të shkollës publik/privat.

Nxënësit me arritjet më të larta për lëndën e matematikës janë nxënësit që ndjekin shkollat e profilit gjimnaz, si për nivelin kombëtar, po ashtu edhe për dy sistemet publik/privat të edukimit. Ndërsa nxënësit me arritjet më të ulta, si në nivel kombëtar, po ashtu edhe për dy sistemet publik dhe privat, janë nxënësit që ndjekin gjimnazin në sistemin me kohë të shkurtuar.

Tabela M-2

| Lloji i shkollës | Profili i shkollës                      | Pikët e fituara në test |                   | Nota e Maturës |                   | Nota Vjetore  |                   |
|------------------|-----------------------------------------|-------------------------|-------------------|----------------|-------------------|---------------|-------------------|
|                  |                                         | Mesatarja e pikëve      | Shmangia mesatare | Nota mesatare  | Shmangia mesatare | Nota mesatare | Shmangia mesatare |
| <b>TOTAL</b>     | Gjimnaz                                 | 24.05                   | 11.77             | 6.61           | 1.64              | 6.60          | 1.80              |
|                  | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh | 18.99                   | 10.46             | 5.89           | 1.48              | 6.04          | 1.24              |
|                  | Artistike; Koreografike, Sportive       | 13.04                   | 6.21              | 5.04           | 0.90              | 5.65          | 1.26              |
|                  | Teknike profesionale                    | 14.14                   | 7.19              | 5.18           | 1.06              | 5.33          | 1.08              |
|                  | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar           | 12.80                   | 4.49              | 4.97           | 0.70              | 5.20          | 0.74              |
| <b>PUBLIK</b>    | Gjimnaz                                 | 23.25                   | 11.57             | 6.50           | 1.62              | 6.42          | 1.76              |
|                  | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh | 18.99                   | 10.46             | 5.89           | 1.48              | 6.04          | 1.24              |
|                  | Artistike; Koreografike, Sportive       | 13.04                   | 6.21              | 5.04           | 0.90              | 5.65          | 1.26              |
|                  |                                         |                         |                   |                |                   |               |                   |

|               |                                         |       |       |      |      |      |      |
|---------------|-----------------------------------------|-------|-------|------|------|------|------|
|               | Teknike profesionale                    | 13.42 | 6.15  | 5.07 | 0.93 | 5.22 | 0.92 |
|               | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar           | 12.80 | 4.49  | 4.97 | 0.70 | 5.20 | 0.74 |
|               | Gjimnaz                                 | 28.76 | 11.86 | 7.27 | 1.62 | 7.64 | 1.69 |
|               | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh | -     | -     | -    | -    | -    | -    |
| <b>PRIVAT</b> | Artistike; Koreografike, Sportive       | -     | -     | -    | -    | -    | -    |
|               | Teknike profesionale                    | 22.83 | 11.81 | 6.46 | 1.64 | 6.60 | 1.69 |
|               | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar           | -     | -     | -    | -    | -    | -    |

Tabela M-3 dhe Tabela M-4, si dhe Grafiku M-3 e Grafiku M-4 japin shpërndarjen (në përqindje) të notave të maturës dhe notave vjetore për lëndën e Matematikës.


**Në provimin e maturës, në nivel kombëtar:**

- kalueshmëria është **94.53%**.
- nota mbizotëruese është **nota 5 me 31.03%**.

Grafiku tregon se, notat 4, 5 dhe 6 kanë një përqindje, shuma e të cilave shkon rreth 58.53% të totalit, shifër që tregon se arritjet e nxënësve në provimin e maturës janë të ulta. Ndërsa përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 shkon në 7.07%.

Tabela M-3

| Nr.                             | Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve | Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës (në %) |               |               |               |               |              |              |
|---------------------------------|----------------------------------------------|----------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|--------------|
|                                 |                                              | 4                                                  | 5             | 6             | 7             | 8             | 9            | 10           |
| <b>1</b>                        | Gjimnaz                                      | 2.31%                                              | 22.86%        | 18.49%        | 14.35%        | 10.13%        | 8.16%        | 6.89%        |
| <b>2</b>                        | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh      | 0.13%                                              | 1.02%         | 0.54%         | 0.25%         | 0.14%         | 0.09%        | 0.12%        |
| <b>3</b>                        | Artistike, Koreografike, Sportive            | 0.34%                                              | 0.75%         | 0.27%         | 0.05%         | 0.04%         | 0.01%        | 0.00%        |
| <b>4</b>                        | Teknike profesionale                         | 2.24%                                              | 4.93%         | 2.23%         | 0.74%         | 0.23%         | 0.14%        | 0.07%        |
| <b>Në nivel kombëtar (dita)</b> |                                              | <b>5.02%</b>                                       | <b>29.57%</b> | <b>21.53%</b> | <b>15.39%</b> | <b>10.53%</b> | <b>8.40%</b> | <b>7.07%</b> |
| <b>5</b>                        | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar                | 0.45%                                              | 1.45%         | 0.50%         | 0.06%         | 0.01%         | 0.00%        | 0.00%        |
| <b>Në nivel kombëtar</b>        |                                              | <b>5.47%</b>                                       | <b>31.03%</b> | <b>22.03%</b> | <b>15.46%</b> | <b>10.55%</b> | <b>8.40%</b> | <b>7.07%</b> |




Grafiku M-3

Në shpërndarjen e notave vjetore të paraqitura në Tabelën M-4, rezulton se nota mbizotëruese është 5 me 43.13% të totalit të nxënësve, që tregon se arritjet e nxënësve në procesin mësimor në lëndën e matematikës kanë qenë të ulta. Po kështu, Grafiku M-4 tregon se, notat 5, 6 dhe 7 kanë një përqindje, shuma e të cilave shkon rreth 71.41% të totalit të nxënësve. Të dhënat e Tabela M-4 tregojnë se përqindjet e nxënësve të vlerësuar me nota 8, 9 dhe 10 gjatë procesit mësimor vjetor nuk e kalojnë vlerat prej 28.59%.

Tabela M-4

| Nr.                             | Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve | Shpërndarja e Notave Vjetore (në %) |               |               |              |              |               |
|---------------------------------|----------------------------------------------|-------------------------------------|---------------|---------------|--------------|--------------|---------------|
|                                 |                                              | 5                                   | 6             | 7             | 8            | 9            | 10            |
| 1                               | Gjimnaz                                      | 32.84%                              | 14.80%        | 10.54%        | 8.84%        | 8.68%        | 10.14%        |
| 2                               | Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni 2 gjuhësh      | 0.02%                               | 0.02%         | 0.01%         | 0.00%        | 0.00%        | 0.00%         |
| 3                               | Artistike, Koreografike, Sportive            | 0.89%                               | 0.30%         | 0.11%         | 0.06%        | 0.08%        | 0.02%         |
| 4                               | Teknike profesionale                         | 7.60%                               | 1.42%         | 0.61%         | 0.35%        | 0.20%        | 0.14%         |
| <b>Në nivel kombëtar (dita)</b> |                                              | <b>41.36%</b>                       | <b>16.54%</b> | <b>11.27%</b> | <b>9.26%</b> | <b>8.97%</b> | <b>10.30%</b> |
| 5                               | Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar                | 1.77%                               | 0.36%         | 0.12%         | 0.04%        | 0.02%        | 0.00%         |
| <b>Në nivel kombëtar</b>        |                                              | <b>43.13%</b>                       | <b>16.90%</b> | <b>11.39%</b> | <b>9.30%</b> | <b>8.99%</b> | <b>10.30%</b> |



Grafiku M-4

Në Tabelën M-5 dhe Tabelën M-6, si dhe Grafikët M-5 e M-6 janë paraqitur në formë tabelare dhe grafike përqindjet e notave në nivel kombëtar sipas urbanizimit fshat/qytet, dhe gjinisë femra/meshkuj për provimin e Maturës 2018 dhe arritjet Vjetore 2018 për lëndën e Matematikës.

Tabela M-5 tregon se, përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës është 7.07% e totalit të nxënësve, prej të cilëve, vetëm 0.55% janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat, ndërsa pjesa tjetër prej 6.52% i përkasin kategorisë qytet. Shihet që, për kategorinë fshat, nota 10 ka përqindjen më të ulët të nxënësve, ndërsa për kategorinë qytet, përqindja më e ulët i takon notës 5, respektivisht me 4.29%.

Të dhënat e Tabelës M-6 dhe Grafikut përkatës M-6 tregojnë se, vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e maturës. Tabela M-6 tregon se, përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e Maturës është 7.07% e totalit të nxënësve, prej të cilëve 5.00% janë vajza dhe 2.08% janë djem.

Për Lëndën e Matematikës, rezulton se:

- Numri i nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës është më i ulët se numri i nxënësve të vlerësuar po me notën 10 gjatë procesit mësimor.
- Përqindja e mbetësve në provimin e maturës për kategorinë “meshkuj” është afërsisht 2 herë më e madhe krahasuar me kategorinë “femra”.
- Në notat 8, 9 dhe 10 të rezultateve të provimit të maturës, si dhe në ato vjetore, vihet re përqindja dominuese e kategorisë “femra” kundrejt kategorisë “meshkuj”.
- Për kategorinë fshat, kemi rënie prej 0.78% të numrit të nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e maturës (0.55%) kundrejt vlerësimit vjetor (1.34%).

- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 4 në provimin e maturës (5.47%) tregon se, përqindja më e lartë i takon nxënësve të qytetit (4.29%) kundrejt nxënësve të fshatit (1.18%), (kjo referuar përqindjes që zënë nxënësit e fshatit kundrejt totalit - rreth 30% e totalit të nxënësve).
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor vjetor është 10,30%, prej të cilëve 7.21% janë vajza, dhe 3.09% djem.


Përqindjet e notave në nivel kombëtar  
MATEMATIKË

Tabela M-5

Matura 2018

| Nota    | Urbanizimi |        | Gjithsej |
|---------|------------|--------|----------|
|         | Fshat      | Qytet  |          |
| Nota 4  | 1.18%      | 4.29%  | 5.47%    |
| Nota 5  | 10.32%     | 20.70% | 31.03%   |
| Nota 6  | 6.10%      | 15.93% | 22.03%   |
| Nota 7  | 3.33%      | 12.12% | 15.46%   |
| Nota 8  | 1.76%      | 8.78%  | 10.55%   |
| Nota 9  | 1.13%      | 7.27%  | 8.40%    |
| Nota 10 | 0.55%      | 6.52%  | 7.07%    |


Përqindjet e notave sipas urbanizimit  
Matura 2018



Vjetore 2018

| Nota    | Urbanizimi |        | Gjithsej |
|---------|------------|--------|----------|
|         | Fshat      | Qytet  |          |
| Nota 4  | 0.00%      | 0.00%  | 0.00%    |
| Nota 5  | 12.48%     | 30.64% | 43.13%   |
| Nota 6  | 4.49%      | 12.41% | 16.90%   |
| Nota 7  | 2.41%      | 8.98%  | 11.39%   |
| Nota 8  | 1.95%      | 7.35%  | 9.30%    |
| Nota 9  | 1.63%      | 7.36%  | 8.99%    |
| Nota 10 | 1.34%      | 8.96%  | 10.30%   |


Përqindjet e notave sipas urbanizimit  
Vjetore 2018




Përqindjet e notave në nivel kombëtar  
MATEMATIKË

Tabela M-6

| Matura 2018 |        |         |          |
|-------------|--------|---------|----------|
| Nota        | Gjinia |         | Gjithsej |
|             | Femra  | Meshkuj |          |
| Nota 4      | 1.77%  | 3.70%   | 5.47%    |
| Nota 5      | 13.08% | 17.94%  | 31.03%   |
| Nota 6      | 11.17% | 10.86%  | 22.03%   |
| Nota 7      | 9.68%  | 5.78%   | 15.46%   |
| Nota 8      | 6.94%  | 3.61%   | 10.55%   |
| Nota 9      | 5.59%  | 2.81%   | 8.40%    |
| Nota 10     | 5.00%  | 2.08%   | 7.07%    |



| Vjetore 2018 |        |         |          |
|--------------|--------|---------|----------|
| Nota         | Gjinia |         | Gjithsej |
|              | Femra  | Meshkuj |          |
| Nota 4       | 0.00%  | 0.00%   | 0.00%    |
| Nota 5       | 15.87% | 27.25%  | 43.13%   |
| Nota 6       | 10.61% | 6.28%   | 16.90%   |
| Nota 7       | 7.63%  | 3.76%   | 11.39%   |
| Nota 8       | 6.53%  | 2.77%   | 9.30%    |
| Nota 9       | 6.24%  | 2.74%   | 8.99%    |
| Nota 10      | 7.21%  | 3.09%   | 10.30%   |



Gjetjet e mësipërme tregojnë se, nëse krahasojmë arritjet e nxënësve në provimin e Maturës 2018 me arritjet Vjetore 2018, arrijmë në përfundimin se arritjet e nxënësve për lëndën e matematikës janë të paqëndrueshme.

Tabela M-7 jep të dhëna mbi shkallën e **paqëndrueshmërisë** së rezultateve Vjetore 2018 (për të cilat nxënësit janë vlerësuar gjatë gjithë vitit shkollor 2017-2018) të krahasuara me rezultatet e marra në provimin e Maturës 2018, për lëndën e Matematikës.

Tabela M-7

| Notat vjetore<br>(në %) |         | Notat e Provimit të Maturës - Matematikë<br>(në %) |               |               |               |               |              |              |
|-------------------------|---------|----------------------------------------------------|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|--------------|
|                         |         | 4                                                  | 5             | 6             | 7             | 8             | 9            | 10           |
| <b>pa notë</b>          | 6.61%   | <b>2.05%</b>                                       | 2.85%         | 1.03%         | 0.33%         | 0.15%         | 0.09%        | 0.12%        |
| <b>5</b>                | 40.27%  | 2.74%                                              | <b>20.10%</b> | 11.28%        | 4.55%         | 1.28%         | 0.29%        | 0.03%        |
| <b>6</b>                | 15.78%  | 0.47%                                              | 5.09%         | <b>4.83%</b>  | 3.33%         | 1.40%         | 0.57%        | 0.09%        |
| <b>7</b>                | 10.64%  | 0.15%                                              | 2.04%         | 2.71%         | <b>2.86%</b>  | 1.83%         | 0.81%        | 0.25%        |
| <b>8</b>                | 8.69%   | 0.05%                                              | 0.74%         | 1.45%         | 2.41%         | <b>2.21%</b>  | 1.37%        | 0.46%        |
| <b>9</b>                | 8.39%   | 0.01%                                              | 0.19%         | 0.57%         | 1.50%         | 2.34%         | <b>2.41%</b> | 1.37%        |
| <b>10</b>               | 9.62%   | 0.01%                                              | 0.02%         | 0.17%         | 0.47%         | 1.33%         | 2.87%        | <b>4.76%</b> |
| <b>Gjithsej</b>         | 100.00% | <b>5.47%</b>                                       | <b>31.03%</b> | <b>22.03%</b> | <b>15.46%</b> | <b>10.55%</b> | <b>8.40%</b> | <b>7.07%</b> |

Të dhënat e kësaj tablele lexohen si vijon:

- Nga rreshti i parafundit i tabelës, lexojmë se, nga totali i nxënësve, vetëm 9.62% e tyre kanë marrë vlerësimin 10 gjatë vitit shkollor në Lëndën e Matematikës, ndërkohë që përqindja e nxënësve që kanë marrë vlerësimin 10 edhe në provimin e Maturës është 7.07% e totalit të nxënësve.

Nëse rezultatet e nxënësve do të ishin të qëndrueshme, atëherë në provimin e maturës, duhet të rezultonin po 9.62% nota 10 në nivel kombëtar. Por, përsëri nga rreshti i parafundit i tabelës, shihet se kemi edhe praninë e nxënësve me: note 4 (0.01%), notë 5 (0.02%); notë 6 (0.17%); notë 7 (0.47%); notë 8 (1.33%); notë 9 (2.87%). Këto shifra tregojnë se, nxënësit e vlerësuar me notë 10 gjatë vitit shkollor, në provimin e maturës janë vlerësuar edhe me notën 4, 5, 6, 7, 8. Shqetësuese është dukuria që, një nxënës i vlerësuar me 10 gjatë procesit mësimor në provimin e maturës është ulur në vlerësim me 2 deri në 3 nota, madje edhe me 4 apo 5 nota.

Nga rreshtat e parë të Tabelës M-7, të dhënat tregojnë se, një përqindje e nxënësve, të cilët janë vlerësuar gjatë vitit shkollor me notën 5, 6 e 7, në provimin e maturës kanë arritur të marrin vlerësimin 7, 8, 9 dhe 10.


Nga 40.27% e nxënësve që gjatë vitit shkollor janë vlerësuar me notën 5, vetëm 20.10% kanë mbajtur po atë notë në provimin e maturës. Ndërsa, prej tyre, ka që në provimin e maturës kanë marrë edhe vlerësime me mbi 2, 3 apo më shumë nota. (Kategoria “pa notë vjetore” prej 1.80% tregon se në databazën e QSHA për ta nuk ka notë vjetore, ose kjo lëndë nuk është lëndë mësimore në maturë.)

## 2) Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës

Grafiku M-8 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e Maturës 2018 në Lëndën e Matematikës. Grafiku paraqet një shpërndarje relativisht normale, por të zhvendosur ndaj boshtit vertikal. Shihet se, rreth 50% e nxënësve janë vlerësuar me pikë që ndodhen në intervalin 0-20 pikë, dhe më tej grafiku vazhdon në rënie.

Grafiku M-8

Shpërndarja MATEMATIKË - 2018




Grafiku M-9 paraqet shpërndarjen kumulative të pikëve të fituara në provimin e Matematikës në Maturën 2018.

Grafiku M-9 tregon se:

- në intervalin 49-50 pikë ndodhen rezultatet e 1.88% e totalit të nxënësve;
- 1.53% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 5 pikë;
- 58.53% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 21 pikë;
- 67.31% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 25 pikë;
- 80.90% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 34 pikë;
- 92.93% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 44 pikë;
- 99.32% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 49 pikë.

Grafiku M-9



Ndër faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e nxënësve në provimin e maturës për lëndën e Matematikës renditim:

- familjarizimi i nxënësve me metodën e testimit me shkrim të njohurive bazuar në kurrikulën kombëtare, e cila ka ardhur edhe si pasojë e publikimit të testeve dhe zgjidhjeve në faqen e web të QSHA, si dhe përdorimi i pyetjeve të ndryshme të testeve të QSHA gjatë procesit mësimor nga ana e mësuesve – kjo si pjesë e përgatitjes për provimet dalëse,
- aplikimi i metodës së korrigjimit të testeve bazuar në 2 (dy) vlerësues të pavarur nga njëri-tjetri,
- fiktiviteti në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor,
- ekzistenca e niveleve të ndryshme cilësie në mësimdhënie gjatë procesit mësimor, kjo më e dallueshme mes qytetit dhe fshatit, si dhe mes sistemit publik dhe atij privat,
- nivele të ndryshme të cilësisë dhe kualifikimit të mësuesve në nivel kombëtar, por edhe mes sistemit privat dhe atij publik, qytetit dhe fshatit,
- shkalla e ulët e faktorëve motivues të mësuesve gjatë procesit mësimor,
- cilësia e teksteve bazë për nxënësit,
- mësimdhënia e bazuar në disa tekste bazë për nxënësit,
- mungesa e një teksti bazë për mësuesit, të miratuar në nivel kombëtar, që do të garantonte standardin bazë të njohurive në mësimdhënie,
- niveli social-ekonomik i familjeve dhe komuniteteve përkatëse ku jetojnë nxënësit.

Nga rezultatet e arritura në test, kanë treguar se nxënësit:

**shfaqin aftësi shumë të mira në:**

- përdorimin dhe zbatimin e marrëdhënieve të ndërsjella ndërmjet bashkësive numerike  $N$ ,  $Z$ ,  $Q$ ,  $R$ ;
- përdorimin shumë mirë të vetive të fuqive;
- përdorimin e vetive të logaritmeve në situata të thjeshta;
- zbatimin e teoremës së Pitagorës;
- gjetjen e limitit të formave të pacaktuara (raste të thjeshta);
- zgjidhjen e ekuacioneve të fuqisë së shkallës së parë dhe të dytë;
- studimin e monotonisë së funksionit me anë të derivatit;
- zbatimin e formulës së gjetjes së ekuacionit të drejtëzës që kalon nëpër dy pika;
- zbatimin e formulës së mesatares aritmetike;
- gjetjen e trajtës së rregullt të ekuacionit të hiperbolës, elipsit dhe parabolës;
- gjetjen e koordinatave të mesit të një segmenti;
- gjetjen e bashkësisë së përcaktimit të një funksioni të dhënë.

**shfaqin aftësi të mira në:**

- shndërrimin e shprehjeve algjebrike me shprehje identike me to;
- ekuacionin e drejtëzës që kalon nga një pikë dhe është paralel ose pingul me drejtëzën  $ax+by+c=0$ ;
- përcaktimin e ekstremumeve të funksionit me anën e derivatit;
- studimin e përkulshmërisë së vijës dhe gjetjen e pikave e infleksionit;
- zgjidhjen me mënyra të ndryshme ekuacione eksponenciale të thjeshta, duke përdorur vetitë kryesore të fuqive;
- zbatimin e formulave për  $a_n$  dhe  $S_n$  në progresionin aritmetik dhe progresionin gjeometrik;
- zbatimin e formulës së syprinës dhe vëllimit të trupave gjeometrikë;
- njehsimin me formula të syprinës, vëllimit, piramidës, cilindrit;
- përkufizimin e vazhdueshmërisë së funksionit në një pikë;
- zbatimin e formulave dhe vetive të funksioneve trigonometrike;
- gjetjen e rrezes vatrore, asimptodat dhe ekuacionin e tangentes pingule ose paralele ndaj parabolës, elipsit dhe hiperbolës në lidhje me një drejtëz të dhënë;
- gjetjen e ekuacionit të përmesores së një segmenti.

**Dobët:**

- njehsimin e syprinës së figurave plane (të thjeshta) me anë të integralit të caktuar;
- zbatimin e teoremës së tre pinguleve;
- interpretimin e përkufizimit klasik të probabilitetit të një ngjarjeje;
- njehsimin e largesës ndërmjet dy pikave, gjatësinë e vektorit dhe prodhimin numerik të dy vektorëve, me koordinata të dhëna.

### 3) Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese

Tabela M-10 jep informacion mbi mesataren e pikëve të fituara në test dhe shmangien mesatare, notën mesatare në provimin e maturës dhe shmangien mesatare, si dhe notën mesatare vjetore dhe shmangien mesatare, në nivel DAR/ZA. Ndërkohë, mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit në nivel kombëtar është 22.45 pikë, nota mesatare vjetore në nivel kombëtar është 6.43, ndërsa nota mesatare e maturës në nivel kombëtar është 6.38.

Të dhënat e Tabelës M-10 tregojnë se:

- 19 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si Dibër, Durrës, Gramsh, Has, Kavajë, Kolonjë, Krujë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Peqin, Përmet, Pogradec, Pukë, Sarandë, Tirana Bashki, Tropojë, Vlorë;
- 6 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **relativisht nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si Berat, Fier, Korçë, Lushnjë, Mallakastër Shkodër;
- 13 DAR/ZA kanë mesatare të pikëve të fituara në test (nga nxënësit e tyre) **ndjeshëm nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si DAR/ZA Bulqizë, Delvinë, Devoll, Elbasan, Gjirokastër, Kamëz, Kuçovë, Mat, Mirditë, Skrapar, Tepelenë, Tiranë Qark.

Tabela M-11 jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e maturës për lëndën e Matematikës, në nivel DAR/ZA, notën mesatare në provimin e maturës, notën mesatare vjetore, si dhe diferenca (NM – NV). Të dhënat e tabelës M-11 tregojnë se:

- 18 DAR/ZA kanë arritje të maturës më të larta se arritjet vjetore, si Dibër, Durrës, Kavajë, Kukës, Kurbin, Librazhd, Peqin, Tropojë etj.;
- 9 DAR/ZA e tjera kanë arritje mesatare të nxënësve në provimin e maturës **ndjeshëm** më të ulta krahasuar me arritjet mesatare vjetore. Diferenca më e madhe mes dy treguesve arrin vlerën (-1.05) në Tepelenë, Delvinë (-1.09).

Tabela M-12 paraqet informacion mbi notën mesatare në provimin e maturës në nivel DAR/ZA, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Nivelet më të ulta të arritjeve mesatare në provimin e maturës i përkasin nxënësve të gjimnazit më kohë të shkurtuar. 19 DAR/ZA kanë notë mesatare mature më të lartë se nota mesatare e maturës në nivel kombëtar, si Dibër, Gramsh, Has, Kavajë, Kukës, Lezhë, Librazhd, Peqin, Përmet, Pogradec, Pukë, Tropojë, Vlorë. 8 DAR/ZA kanë notë mesatare mature **ndjeshëm** më të ulët se nota mesatare e maturës në nivel kombëtar, si Bulqizë, Elbasan, Kamëz, Kuçovë, Malësi e Madhe, Skrapar.

Tabela M-13 paraqet informacion mbi notën mesatare vjetore në nivel DAR/ZA, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; tekniko-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Ashtu si për notën mesatare në provimin e maturës, edhe për notën mesatare vjetore, nxënësit e gjimnazit me kohë të shkurtuar kanë përgjithësisht arritje më të ulta krahasuar me nxënësit e shkollave të profileve të tjera. 17 DAR/ZA kanë notë mesatare vjetore më të lartë se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar, si Delvinë, Fier, Gramsh, Gjirokastër, Has, Tepelenë, Tiranë Bashki, Tropojë, Vlorë, etj. 7 DAR/ZA kanë notë mesatare vjetore **ndjeshëm** më të ulët se nota mesatare vjetore në nivel kombëtar, si Bulqizë, Dibër, Kamëz, Malësi e Madhe, Skrapar, Shkodër, etj.

Tabela M-10

| Nr. | DAR/ZA         | Pikët e fituara në test |                   | Nota e Maturës |                   | Nota Vjetore  |                   |
|-----|----------------|-------------------------|-------------------|----------------|-------------------|---------------|-------------------|
|     |                | Mesatarja e pikëve      | Shmangia mesatare | Nota mesatare  | Shmangia mesatare | Nota mesatare | Shmangia mesatare |
| 1   | Berat          | 20.15                   | 11.30             | 6.05           | 1.60              | 6.33          | 1.75              |
| 2   | Bulqizë        | 16.60                   | 9.21              | 5.52           | 1.35              | 6.11          | 1.64              |
| 3   | Delvinë        | 19.50                   | 9.90              | 5.97           | 1.41              | 7.05          | 1.86              |
| 4   | Devoll         | 21.72                   | 9.86              | 6.31           | 1.38              | 6.34          | 1.82              |
| 5   | Dibër          | 25.29                   | 10.22             | 6.81           | 1.42              | 5.83          | 1.53              |
| 6   | Durrës         | 23.46                   | 11.69             | 6.53           | 1.64              | 6.30          | 1.72              |
| 7   | Elbasan        | 19.76                   | 11.16             | 5.98           | 1.58              | 6.16          | 1.72              |
| 8   | Fier           | 21.88                   | 10.93             | 6.31           | 1.54              | 6.54          | 1.79              |
| 9   | Gramsh         | 24.30                   | 10.50             | 6.67           | 1.47              | 6.53          | 1.77              |
| 10  | Gjirokastrë    | 19.67                   | 11.24             | 6.00           | 1.59              | 6.65          | 1.83              |
| 11  | Has            | 34.24                   | 10.77             | 8.02           | 1.44              | 6.61          | 1.62              |
| 12  | Kamëz          | 16.82                   | 8.28              | 5.57           | 1.21              | 6.09          | 1.55              |
| 13  | Kavajë         | 28.53                   | 12.16             | 7.24           | 1.66              | 6.68          | 1.73              |
| 14  | Kolonjë        | 22.89                   | 10.33             | 6.48           | 1.43              | 6.73          | 1.87              |
| 15  | Korçë          | 20.91                   | 12.01             | 6.14           | 1.70              | 6.40          | 1.82              |
| 16  | Krujë          | 23.32                   | 10.45             | 6.53           | 1.46              | 6.39          | 1.78              |
| 17  | Kuçovë         | 16.08                   | 11.13             | 5.48           | 1.55              | 6.35          | 1.70              |
| 18  | Kukës          | 25.07                   | 11.93             | 6.75           | 1.67              | 6.51          | 1.72              |
| 19  | Kurbin         | 27.67                   | 10.69             | 7.14           | 1.46              | 6.42          | 1.68              |
| 20  | Lezhë          | 23.90                   | 11.01             | 6.61           | 1.53              | 6.30          | 1.79              |
| 21  | Librazhd       | 23.24                   | 10.83             | 6.52           | 1.51              | 6.37          | 1.74              |
| 22  | Lushnjë        | 22.31                   | 11.69             | 6.36           | 1.65              | 6.71          | 1.86              |
| 23  | Malësi e Madhe | 17.78                   | 7.77              | 5.73           | 1.13              | 5.60          | 1.34              |
| 24  | Mallakastër    | 20.90                   | 10.72             | 6.17           | 1.52              | 6.69          | 1.81              |
| 25  | Mat            | 17.05                   | 9.63              | 5.59           | 1.38              | 6.14          | 1.66              |
| 26  | Mirditë        | 18.51                   | 9.90              | 5.85           | 1.39              | 6.30          | 1.78              |
| 27  | Peqin          | 31.04                   | 12.11             | 7.59           | 1.63              | 6.74          | 1.73              |
| 28  | Përmet         | 25.76                   | 13.90             | 6.82           | 1.93              | 6.36          | 1.76              |
| 29  | Pogradec       | 26.75                   | 11.50             | 7.00           | 1.58              | 6.71          | 1.71              |
| 30  | Pukë           | 23.79                   | 9.62              | 6.62           | 1.33              | 6.31          | 1.64              |
| 31  | Sarandë        | 23.90                   | 10.31             | 6.62           | 1.43              | 6.73          | 1.84              |
| 32  | Skrapar        | 18.51                   | 9.85              | 5.81           | 1.42              | 5.78          | 1.53              |
| 33  | Shkodër        | 20.14                   | 10.62             | 6.05           | 1.51              | 6.03          | 1.58              |
| 34  | Tepelenë       | 19.89                   | 9.38              | 6.05           | 1.33              | 7.10          | 1.90              |
| 35  | Tiranë bashki  | 24.38                   | 12.60             | 6.64           | 1.76              | 6.73          | 1.85              |
| 36  | Tiranë Qark    | 18.99                   | 10.71             | 5.88           | 1.52              | 6.07          | 1.62              |
| 37  | Tropojë        | 32.86                   | 9.91              | 7.85           | 1.31              | 6.49          | 1.76              |
| 38  | Vlorë          | 23.19                   | 12.55             | 6.47           | 1.77              | 6.71          | 1.88              |

Tabela M-11

| Nr.              | DAR / ZA       | Kalueshmëria në provimin e Maturës | Nota Mesatare e Maturës (NM) | Nota Mesatare Vjetore (NV) | Diferenca e Notës së Maturës me Vjetoren NM-NV |
|------------------|----------------|------------------------------------|------------------------------|----------------------------|------------------------------------------------|
| 1                | Berat          | 90.06%                             | 6.05                         | 6.33                       | -0.28                                          |
| 2                | Bulqizë        | 88.79%                             | 5.52                         | 6.11                       | -0.59                                          |
| 3                | Delvinë        | 97.44%                             | 5.97                         | 7.05                       | -1.09                                          |
| 4                | Devoll         | 98.46%                             | 6.31                         | 6.34                       | -0.04                                          |
| 5                | Dibër          | 98.36%                             | 6.81                         | 5.83                       | 0.98                                           |
| 6                | Durrës         | 95.34%                             | 6.53                         | 6.30                       | 0.23                                           |
| 7                | Elbasan        | 92.96%                             | 5.98                         | 6.16                       | -0.18                                          |
| 8                | Fier           | 96.29%                             | 6.31                         | 6.54                       | -0.23                                          |
| 9                | Gramsh         | 98.23%                             | 6.67                         | 6.53                       | 0.14                                           |
| 10               | Gjirokastrë    | 86.37%                             | 6.00                         | 6.65                       | -0.64                                          |
| 11               | Has            | 99.52%                             | 8.02                         | 6.61                       | 1.41                                           |
| 12               | Kamëz          | 91.84%                             | 5.57                         | 6.09                       | -0.51                                          |
| 13               | Kavajë         | 98.72%                             | 7.24                         | 6.68                       | 0.56                                           |
| 14               | Kolonjë        | 99.15%                             | 6.48                         | 6.73                       | -0.25                                          |
| 15               | Korçë          | 91.50%                             | 6.14                         | 6.40                       | -0.25                                          |
| 16               | Krujë          | 99.58%                             | 6.53                         | 6.39                       | 0.14                                           |
| 17               | Kuçovë         | 76.32%                             | 5.48                         | 6.35                       | -0.87                                          |
| 18               | Kukës          | 97.17%                             | 6.75                         | 6.51                       | 0.24                                           |
| 19               | Kurbin         | 99.52%                             | 7.14                         | 6.42                       | 0.72                                           |
| 20               | Lezhë          | 97.01%                             | 6.61                         | 6.30                       | 0.30                                           |
| 21               | Librazhd       | 96.65%                             | 6.52                         | 6.37                       | 0.15                                           |
| 22               | Lushnjë        | 93.39%                             | 6.36                         | 6.71                       | -0.35                                          |
| 23               | Malësi e Madhe | 96.94%                             | 5.73                         | 5.60                       | 0.13                                           |
| 24               | Mallakastër    | 97.93%                             | 6.17                         | 6.69                       | -0.52                                          |
| 25               | Mat            | 91.97%                             | 5.59                         | 6.14                       | -0.54                                          |
| 26               | Mirditë        | 92.26%                             | 5.85                         | 6.30                       | -0.45                                          |
| 27               | Peqin          | 100.00%                            | 7.59                         | 6.74                       | 0.84                                           |
| 28               | Përmet         | 96.88%                             | 6.82                         | 6.36                       | 0.46                                           |
| 29               | Pogradec       | 98.40%                             | 7.00                         | 6.71                       | 0.30                                           |
| 30               | Pukë           | 99.51%                             | 6.62                         | 6.31                       | 0.30                                           |
| 31               | Sarandë        | 97.78%                             | 6.62                         | 6.73                       | -0.11                                          |
| 32               | Skrapar        | 95.16%                             | 5.81                         | 5.78                       | 0.03                                           |
| 33               | Shkodër        | 92.71%                             | 6.05                         | 6.03                       | 0.02                                           |
| 34               | Tepelenë       | 97.06%                             | 6.05                         | 7.10                       | -1.05                                          |
| 35               | Tiranë bashki  | 95.04%                             | 6.64                         | 6.73                       | -0.09                                          |
| 36               | Tiranë Qark    | 92.48%                             | 5.88                         | 6.07                       | -0.19                                          |
| 37               | Tropojë        | 100.00%                            | 7.85                         | 6.49                       | 1.36                                           |
| 38               | Vlorë          | 92.24%                             | 6.47                         | 6.71                       | -0.24                                          |
| <b>Republika</b> |                | <b>94.53%</b>                      | <b>6.38</b>                  | <b>6.43</b>                | <b>-0.05</b>                                   |

| Nr. | DAR/ZA         | Gjimnazi      | Gjimnaz gjuhësor & Seksioni 2 gjuhesh | Artistike, Koreografike, Sportive | Teknike Profesionale | Gjimnaz- me kohe te shkurtuar | LËNDA: MATEMATIKË       |       |           |      |
|-----|----------------|---------------|---------------------------------------|-----------------------------------|----------------------|-------------------------------|-------------------------|-------|-----------|------|
|     |                | Nota Mesatare | Nota Mesatare                         | Nota Mesatare                     | Nota Mesatare        | Nota Mesatare                 | Nota Mesatare e Maturës |       | Diferenca |      |
|     |                | (NM)          | (NM)                                  | (NM)                              | (NM)                 | (NM)                          | (NM)                    | (NMk) | (NM-NMk)  |      |
| 1   | Berat          | 6.31          |                                       | 4.52                              | 4.60                 | 4.41                          | 6.05                    | 6.38  | -0.33     |      |
| 2   | Bulqizë        | 5.63          |                                       |                                   | 4.47                 |                               | 5.52                    | 6.38  | -0.86     |      |
| 3   | Delvinë        | 6.03          |                                       |                                   | 5.75                 |                               | 5.97                    | 6.38  | -0.41     |      |
| 4   | Devoll         | 6.31          |                                       |                                   | .                    |                               | 6.31                    | 6.38  | -0.07     |      |
| 5   | Dibër          | 6.89          |                                       |                                   | 6.75                 | 5.30                          | 6.81                    | 6.38  | 0.43      |      |
| 6   | Durrës         | 6.96          | 9.08                                  | 5.22                              | 5.06                 | 5.12                          | 6.53                    | 6.38  | 0.15      |      |
| 7   | Elbasan        | 6.24          | 5.07                                  | 5.34                              | 5.42                 | 4.77                          | 5.98                    | 6.38  | -0.40     |      |
| 8   | Fier           | 6.55          |                                       | 4.22                              | 5.24                 | 4.66                          | 6.31                    | 6.38  | -0.07     |      |
| 9   | Gramsh         | 6.67          |                                       |                                   | .                    | .                             | 6.67                    | 6.38  | 0.29      |      |
| 10  | Gjirokastër    | 6.44          | 5.52                                  | 4.00                              | 4.22                 | 4.84                          | 6.00                    | 6.38  | -0.38     |      |
| 11  | Has            | 8.02          |                                       |                                   | .                    |                               | 8.02                    | 6.38  | 1.64      |      |
| 12  | Kamëz          | 5.75          |                                       |                                   | 4.66                 |                               | 5.57                    | 6.38  | -0.81     |      |
| 13  | Kavajë         | 7.30          |                                       |                                   | 5.75                 |                               | 6.73                    | 7.24  | 6.38      | 0.86 |
| 14  | Kolonjë        | 6.48          |                                       |                                   | .                    |                               | .                       | 6.48  | 6.38      | 0.10 |
| 15  | Korçë          | 6.60          | 6.06                                  | 4.75                              | 4.65                 | 4.43                          | 6.14                    | 6.38  | -0.24     |      |
| 16  | Krujë          | 6.58          |                                       |                                   | .                    | 5.62                          | 6.53                    | 6.38  | 0.15      |      |
| 17  | Kuçovë         | 5.60          |                                       |                                   | 4.02                 |                               | 5.48                    | 6.38  | -0.90     |      |
| 18  | Kukës          | 6.75          |                                       |                                   | .                    |                               | 6.75                    | 6.38  | 0.37      |      |
| 19  | Kurbin         | 7.14          |                                       |                                   | .                    |                               | 7.14                    | 6.38  | 0.76      |      |
| 20  | Lezhë          | 6.86          |                                       |                                   | 4.89                 | 4.92                          | 6.61                    | 6.38  | 0.23      |      |
| 21  | Librazhd       | 6.65          |                                       |                                   | 4.45                 | 5.47                          | 6.52                    | 6.38  | 0.14      |      |
| 22  | Lushnjë        | 6.52          |                                       |                                   | 4.34                 |                               | 6.36                    | 6.38  | -0.02     |      |
| 23  | Malësi e Madhe | 5.73          |                                       |                                   |                      |                               | 5.73                    | 6.38  | -0.65     |      |
| 24  | Mallakastër    | 6.17          |                                       |                                   |                      |                               | 6.17                    | 6.38  | -0.21     |      |
| 25  | Mat            | 5.59          |                                       |                                   |                      |                               | 5.59                    | 6.38  | -0.79     |      |
| 26  | Mirditë        | 6.08          |                                       |                                   | 5.16                 |                               | 5.85                    | 6.38  | -0.53     |      |
| 27  | Peqin          | 7.59          |                                       |                                   |                      |                               | 7.59                    | 6.38  | 1.21      |      |
| 28  | Përmet         | 6.82          |                                       |                                   |                      |                               | 6.82                    | 6.38  | 0.44      |      |
| 29  | Pogradec       | 7.12          |                                       |                                   | 4.93                 |                               | 7.00                    | 6.38  | 0.62      |      |
| 30  | Pukë           | 6.62          |                                       |                                   | .                    |                               | 6.62                    | 6.38  | 0.24      |      |
| 31  | Sarandë        | 6.87          |                                       |                                   | 4.99                 |                               | 6.62                    | 6.38  | 0.24      |      |
| 32  | Skrapar        | 6.26          |                                       |                                   | 4.89                 | 4.62                          | 5.81                    | 6.38  | -0.57     |      |
| 33  | Shkodër        | 6.26          | 6.07                                  | 4.66                              | 5.43                 | 4.96                          | 6.05                    | 6.38  | -0.33     |      |
| 34  | Tepelenë       | 6.05          | .                                     | .                                 | .                    | .                             | 6.05                    | 6.38  | -0.33     |      |
| 35  | Tiranë bashki  | 7.03          | 5.77                                  | 5.18                              | 5.53                 | 5.05                          | 6.64                    | 6.38  | 0.26      |      |
| 36  | Tiranë Qark    | 5.93          |                                       |                                   |                      | 4.92                          | 5.88                    | 6.38  | -0.50     |      |
| 37  | Tropojë        | 7.85          |                                       |                                   |                      | .                             | 7.85                    | 6.38  | 1.47      |      |

|    |       |      |  |      |      |      |      |      |      |
|----|-------|------|--|------|------|------|------|------|------|
| 38 | Vlorë | 6.79 |  | 5.36 | 4.56 | 5.18 | 6.47 | 6.38 | 0.09 |
|----|-------|------|--|------|------|------|------|------|------|

Tabela M-13


| Nr. | DAR/ZA         | Gjimnazi      | Gjimnaz gjuhësor & Seksioni 2 gjuhesh | Artistike, Koreografike, Sportive | Teknike Profesionale | Gjimnaz- me kohë të shkurtuar | LËNDA: MATEMATIKË     |       |                    |      |
|-----|----------------|---------------|---------------------------------------|-----------------------------------|----------------------|-------------------------------|-----------------------|-------|--------------------|------|
